

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7949
E martë, 10 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Kuçi dhe Kilaj deklarohen të pafajshëm para Gjykatës Speciale

FACE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KMDLNJ-ja KRITIKON PROCESIN GJYQËSOR TË SPECIALES: GJYKATË RACISTE, MBI KUSHTETUTEN DHE SHTETIN E KOSOVËS

FAQE 4-5



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ashpër ndaj veprimeve të fundit të Gjykatës Speciale, duke e cilësuar atë si një institucion

“racist, mbi Kushtetutën dhe mbi shtetin”. Në një reagim për medie, KMDLNj ka dënuar arrestimin e ish-pjesëtarit të UÇK-së, Fadil Fazliu, ish-shefit të AKI-së, Bashkim Smakaj, ish-

kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj dhe bastisjen e shtëpisë së Hajredin Kuçit, duke theksuar se këto veprime janë kryer në mënyrë të padrejtë dhe të motivuar politikisht

MOSREALIZIMI I REFORMËS NË DREJTËSI PO KONSIDEROHET DËSHTIM I QEVERISË

F. 3



SBASHK-u VAZHDON KONSULTIMET PËR VEPRIMET SINDIKALE PAS PROTESTËS SË 4 DHJETORIT, KËRKON DIALOG ME MINISTREN NAGAVCI

F. 7



AKTUALE




BOTA BËN THIRRJE PËR STABILITET DHE PAQE PAS RRËZIMIT TË ASSADIT NGA PUSHTETI F. 2

OSMANI TAKON RAPORTUESIN PËR KOSOVËN, RIHO TERRAS, DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMET NË KOSOVË F. 5

PËRURORHET RENOVIMI I TRI KLINIKAVE NË QKUK F. 6

ANALISTI ARTON DEMHASAJ I BASHKOHET AAK-SË, I HYN GARËS PËR DEPUTET F. 7

EKONOMI



KOSOVA DUHET TË INVESTOJË 2.8 MILIARDË EURO PËR T'I RUAJTUR KOMUNAT NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE F. 8

SHPËRTHIMI NË KANALIN IBËR-LEPENC, IKSHPK-JA: UJI MUND TË PËRDORET PËR PIJE F. 8

SPORT



BACH: KOSOVA ËSHTË HISTORI E RRALLË SUKSESI F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi s'e përjashton mundësinë e hetimit të Jack Smithit: I çmenduri po kthehet në Hagë ku mund të ekzekutojë njerëz

WASHINGTON, 9 DHJETOR - Presidenti i zgjedhur amerikan, Donald Trump ka paralajmëruar se ish-kryeprokurori i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Jack Smith, do të kthehet në Gjykatën Speciale në Hagë. Në një intervistë të fundit në NBC, Trump foli për Smithin, i cili para një viti ishte emëruar për t'i mbikëqyrur hetimet penale ndaj tij. "Në historinë e vendit tonë asgjë e tillë nuk ka ndodhur kurrë. Dhe unë i kam fituar këto raste. Unë i kam fituar të gjitha dhe pjesa tjetër janë në proces të fitimit. I çmenduri Jack Smith është duke u kthyer në Hagë ku mund të ekzekutojë njerëz. Këtu duhej të qëndronte. Unë mendoj se ai është i rrezikshëm edhe atje", tha presidenti i

zgjedhur. Trumpi kujtoi akuzat e Smithit, ndërsa tha se, mbase, ai e ka ndihmuar të fitonte bindshëm në zgjedhjet presidenciale. "Ndoshta më ndihmoi, sepse unë mora votën më të madhe, më shumë vota që një republikan ka marrë ndonjëherë në histori". I pyetur nëse do ta donte hetimin e prokurorit Jack Smith, Donald Trump tha: "Epo, unë mendoj se ai është shumë i korruptuar, por dua që ajo të bëjë çfarëdo që ajo do", duke iu referuar Pam Bond, gruas të cilën ai e ka nominuar për prokurorë të përgjithshme. Insistimet të gazetares se a do të ndikonte te Bond që Smith të ndiqej penalisht, Trump iu përgjigj se nuk do t'i japë udhëzime. "Ajo është një



person shumë i zgjuar. Ajo ishte një prokurorë e madhe e përgjithshme në Florida. Ajo është me shumë përvojë. Unë dua që ajo ta bëjë atë që dëshiron ta bëjë. Unë nuk do ta udhëzoj atë ta bëjë këtë, jo". Smith është prokurori që i akuzoi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputeti Rexhep Selimi po mbahen ende në paraburgimin e Gjykatës Speciale në sajë të asaj aktakuze. Në paraburgim në Hagë qëndrojnë edhe ish-komandantë e ish-ushtarë të UÇK-së për akuza të ngjashme. Disa tashmë janë dënua.

Bota bën thirrje për stabilitet dhe paqe pas rrëzimit të Assadit nga pushteti

DAMASKU, 9 DHJETOR - Fuqitë botërore janë zotuar se do të punojnë për stabilitet në Siri dhe rajonin përreth, pasi rebelët e udhëhequr nga islamistët kanë rrëzuar të dielën liderin e kamotshëm sirian Bashar al-Assad. Aleatja e Assadit, Moska, ka thënë se trupat ruse në Siri janë në alarm të madh, por që rebelët kanë "garantuar" sigurinë e bazave të saj ushtarake në këtë shtet. Para raportimeve se Assadi dhe familja e tij gjenden në Moskë dhe u është miratuar azili, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë se Siria nuk duhet të lejohet të mbetet në duart e "grupit terrorist". Rusia ka qenë aleate e Sirisë që një kohë, duke ofruar ndihmë ushtarake dhe politike për regjimin e Assadit, sidomos pas



luftës civile që pati nisur më 2011. Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se do të angazhohet me të gjitha grupet siriane "për të krijuar një rrugë tranzicioni prej regjimit të Assadit, drejt një Sirie të pavarur dhe sovranë". "Assadi duhet të mbahet përgjegjës", ka thënë ai kur është pyetur se çfarë duhet të ndodhë me presidentin e rrëzuar.

Pekini ka thënë se është duke shikuar nga afër zhvillimet në Siri dhe shpreson që Siria do t'i rikthehet stabilitetit sa më shpejt që është e mundur. Ministria e Jashtëm e Iranit ka thënë se pret që marrëdhëniet "miqësore" me Sirinë të vazhdojnë. Ministri i Jashtëm turk, Hakan Fidan, ka thënë se vendi i tij, i cili i ka mbështetur lëvizjet e rebelëve në Siri, do të ndihmojë në "shërimin e plagëve të Sirisë dhe do t'i garantojë unitetin, integritetin dhe sigurinë". I dërguari i Kombeve të Bashkuara në Siri, Geir Pedersen, e ka quajtur marrjen e vendit nga rebelët si "moment vendimtar", pas gati 14 vjetësh luftë civile. "Do të shohim përpara me kujdes për hapjen e kapitullit të ri - të paqes, pajtimit, dinjitetit dhe

gjitëpërfshirës së të gjithë sirianëve", ka thënë ai. Presidenti francez Emmanuel Macron e ka mirëpritur rënien e "shtetit barbar" të Assadit në Siri. Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë se Berlioni është i gatshëm ta bëjë "kontributin e vet" për një zgjidhje politike, për të sjellë paqe në shtetin e shkatërruar nga lufta. "Bashar Al-Assad i ka shtypur njerëzit e vet në mënyrë brutale. Ai ka pafundësisht njerëz në ndërgjegjen e vet", ka thënë lideri gjerman. Sirianët janë parë nëpër rrugë duke festuar rrëzimin e Assadit, kanë rrëzuar statuja dhe kanë plaçkitur ndërtesa qeveritare. Kryeministri i Sirisë, Mohammad Ghazi al-Jalali, ka thënë përmes një video-incizimi se qeveria e tij është e

gatshme "të bashkëpunojë me çdo udhëheqës të zgjedhur nga njerëzit". Ai është parë duke u larguar nga shtëpia e tij më 8 dhjetor, në shoqëri të burrave të armatosur, pas raportimeve se do të takojë udhëheqësinë e grupit rebel sunit, Hayat Tahrir al-Sham (HTS), e cila e ka udhëhequr ofensivën kundër regjimit të Assadit. HTS është organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Në vitet e fundit ky grup militant islamist i ka prishur lidhjet me Al-Kaidën dhe ka tentuar të paraqitet si alternativë pragmatike ndaj qeverisë siriane. Megjithatë, ka shqetësime për abuzime që ka kryer grupi, si dhe për lidhjet me grupe të tjera terroriste.

Zelensky: 43 000 ushtarë ukrainas janë vrarë në luftë

KIEV, 9 DHJETOR - Rreth 43 000 ushtarë ukrainas janë vrarë prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky në një deklaram të rrallë për numrin e viktimave. Në një postim në rrjetet sociale, presidenti ukrainas ka thënë se janë raportuar 370 000 persona të plagosur, ndonëse në këtë shifër ai ka thënë se përfshihen edhe ushtarët që janë plagosur më shumë se një herë. Ai ka pretenduar se si pasojë e luftës janë vrarë 198 000 ushtarë rusë dhe janë plagosur 550 000 të tjerë.

Kievi dhe Moska kanë publikuar rregullisht vlerësime për humbjet që ka pësuar pala tjetër, mirëpo asnjëherë nuk kanë folur në hollësi. Shifra e re në anën ukrainase përbën një rritje të konsiderueshme të vdekjeve prej nisjes së luftës. Zelensky pati thënë në shkurt të këtij viti se shifra e viktimave shkon në 31 000. Vlerësimet e Zelenskyt për humbjet e palës ruse janë të ngjashme me ato që kanë ofruar zyrtarët perëndimorë, të cilët vlerësojnë se Rusia ka regjistruar 800 000 viktima,

përfshirë të vrarët dhe të plagosurit. Moska hedh poshtë këto shifra. Përmes një deklaramte, Kremli ka pretenduar se humbjet e ukrainaseve janë "disa herë më të mëdha" sesa ato ruse. Zhvillimet e fundit kanë ndikuar në rritje të numrit të të vdekurve. Forcat ushtarake ruse vazhdojnë të bëjnë avancime të vogla në vijën e frontit në lindje të Ukrainës, si dhe në rajonin rus Kursk. Forcat ukrainase kontrollojnë pjesë të vogla të territorit rus në Kursk, të cilin e kanë fituar

përmes një ofensive të befasishme në Rusi në gusht të këtij viti. Rusia e ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014. Tetë vjet më vonë e ka nisur luftën e plotë në Ukrainë, duke pushtuar territor në jug dhe lindje të shtetit. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur



ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Kurti, kandidat i vetëm nga LV-ja për kryeministër në zgjedhjet e 9 shkurtit

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Mes qindra anëtarëve dhe aktivistëve, bashkëpunëtorëve, mbështetësve dhe miqve të shumtë të Lëvizjes Vetëvendosje, në mbledhjen LVII të Këshillit të Përgjithshëm, kryetari i Lëvizjes, kryeministri aktual Albin Kurti, u zgjodh kandidat për kryeministër në zgjedhjet e ardhshme që do të mbahen më 9 shkurt 2025. Për ta paraqitur kandidaturën e kryetarit të Lëvizjes, kryeministrit Albin Kurti, u mbajt një fjalë hyrëse nga

kryetari i Kuvendit, njëkohësisht nënkryetari i parë i Lëvizjes, Glauk Konjufca. Si bashkëpunëtor i Kurtit ndër vite, Konjufca foli për vlerat që e bëjnë Albin Kurtin udhëheqësin, liderin dhe kryeministrin më të vërtetë në këto zgjedhje. Ai theksoi rrugëtimin e vështirë, plot me sakrificë dhe vetëmohim, që Kurti ka ndjekur për ta bërë organizatën që ai drejton, organizatën më të fuqishme politike jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë



hapësirën shqiptare. Konjufca tha se Albin Kurti është më meritori, më i përgatituri dhe më i devotshmi për të qenë kryeministër i Republikës së Kosovës. Ndërkaq Kurti e përfundoi fjalimin me një thirrje për bashkëpunim dhe angazhim të palodhshëm nga të gjithë anëtarët dhe aktivistët e Lëvizjes, duke theksuar se "së bashku mund t'i arrijmë qëllimet tona për një Kosovë edhe më të fortë, edhe më të zhvilluar".

Mosrealizimi i reformës në drejtësi po konsiderohet dështim i qeverisë

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) thotë se qeveria ka dështuar sa i përket reformës në drejtësi. Hulumtuesi Gëzim Shala ka përmendur mungesën e vetingut si dështim në këtë proces, që ishte premtim i qeverisë. IKD ka paraqitur të hënën raportin me titull "Dështimi i reformës në drejtësi", aktivitet që po mbahet në kuadër të "Javës Kundër Korrupsionit 2024". "Përderisa në fillim të mandatit është ndryshuar ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vetëm një nen dhe janë injoruar problemet e tjera të këtij ligji, pra nuk janë hapur edhe problemet e tjera. Ndërkaq, tash kur po përfundon mandati, ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ende nuk është i reformuar, ende nuk ka të drejtë ankese nëse një autoritet kompetent e hedh një ankesë disiplinore dhe të gjitha këto çështje e ndërtojnë argumentin se reforma në drejtësi në kuptimin e plotë të fjalës ka dështuar dhe nuk është arritur kjo reformë përkundër premtimeve dhe pritjeve të mëdha që kjo reformë të ndodhë", ka thënë ai. Në këtë tryezë, koordinatori i Departamentit për Drejtësi në Partinë Demokratike të



Kosovës, Përparim Gruda, ka kritikuar qeverinë Kurti për mospunë në reformën për drejtësi. "Qeveria nuk ka miratuar strategji kundër korrupsionit, është shprehje e mungesës totale të vullnetit politik për korrupsionin, po ky vend ka një standard, ai standard është që kur njerëzit akuzohen për korrupsion, nuk ndodh si ka ndodhur në qeveritë e kaluara, jo që kanë bërë mrekulli, por qeveritë e kaluara, kryeministrat, kanë bërë një distancë ndaj njerëzve të akuzuar dhe i kanë lënë të paktën organet e

drejtësisë ta bëjnë punën e vet. Ky standard më nuk ekziston. Sa herë akuzohet një ministër, kryeministri në kuvend i merr në mbrojtje të akuzuarit dhe i sulmon gjyqtarët dhe prokurorët. E keni ministrin e Drejtësisë që bën të njëjtën që është totalisht jashtë funksionit të saj, pasi që përshkrimet e tyre janë ta forcojnë sistemin e drejtësisë. Kjo është qeveria më e dështuar që ka pasur Kosova prej që është e lirë, e jo vetëm e pavarur", ka thënë ai. Shef i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka

thënë se Kosova po përballlet me korrupsion. "Si ka mundësi të votohet një familjar i një zëvendëskryeministri duke qenë prezent?! A e dini çfarë konflikt interesi është ky?! A e dini çfarë praktike është kjo?! Kjo është praktikë e pabesueshme, e paimagjinueshme në një shtet. Në një rast e njoh personin në fjalë, është një zonjë e nderuar, mirëpo prej konceptit është gabim. Nuk po e gjykoj individin, por mendësia është total gabim. Tjetra çështje lidhet

drejtpërdrejt me luftën kundër korrupsionit. Ne e kemi armike Serbinë, por armiku i shoqërisë Kosovë e Shqipëri është korrupsioni. Ne duhet të flasim hapur sidomos gjatë kësaj jave, pasi që është problem serioz që duhet luftuar nga të gjithë ne. Korrupsioni është kancer", ka thënë ai. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka radhitur, ndër të tjera, si dështim të qeverisë edhe mosjetësimin e reformës në Këshillin Prokurorial si dhe mungesën e Strategjisë Kundër Korrupsionit.

Gazetarja Albana Haxhimustafa - Murseli i bashkohet PDK-së, garon për deputete

Prishtinë, 9 dhjetor - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka mirëpritur në parti gazetaren Albana Haxhimustafa - Murseli, e cila do të jetë kandidate e PDK-së për deputete. Krasniqi ka thënë se Haxhimustafa - Murseli mishëron angazhimin, integritetin dhe vizionin. "Me

një karrierë të gjatë në gazetari dhe aktivizëm social, ajo ka dëshmuar aftësi të jashtëzakonshme për të frymëzuar dhe për të ndërtuar të ardhmen", ka theksuar ai. Ndërsa Albana Haxhimustafa - Murseli ka thënë se gjithmonë është angazhuar për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri. "E rritur në një familje me vlera

patriotike, si vajzë e një ish-të burgosuri politik dhe një aktivisteje të shquar, kam trashëguar atdhedashurinë dhe përkushtimin për liri e drejtësi. Këto vlera dua t'i përfaqësoj edhe në Kuvend: të jem një zë i ri për gratë, të rinjtë dhe çdo qytetar, për ta ndërtuar së bashku një Kosovë më të mirë", është zotuar ajo.





KMDLNj-ja kritikon procesin gjyqësor të Speciales: Gjykatë raciste, mbi Kushtetutën dhe shtetin e Kosovës

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ashpër ndaj veprimeve të fundit të Gjykatës Speciale, duke e cilësuar atë si një institucion “racist, mbi Kushtetutën dhe mbi shtetin”. Në një reagim për medie, KMDLNj ka dënuar arrestimin e ish-pjesëtarit të UÇK-së, Fadil Fazliu, ish-shëfrit të AKI-së, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj dhe bastisjen e shtëpisë së Hajredin Kuçit, duke theksuar se këto veprime janë kryer në mënyrë të padrejtë dhe të motivuar politikisht

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 DHJETOR - “Policië të pidentifikuar para dy dite arrestuan Bashkim Smakën, luftëtarin e UÇK-së dhe ish-shëfrit e AKI-së, Fadil Fazliun, ushtarin e UÇK-së dhe vëlla të dy dëshmorëve të Kombit, Fahri dhe Bahri Fazliu, Isni Kilaj, ushtarin e UÇK-së dhe ish-kryetarin e Malishevës. Për orë të tëra bastisën shtëpinë e Hajredin Kuçit, bartës i shumë posteve të larta në Kosovën e pasluftës ish-ministër i Drejtësisë dhe pjesë e ekipit mbrojtës të presidentit Thaçi në Hagë. Atij iu la urdhërlajmërimi për paraqitje para Gjykatës Speciale Raciste në Hagë më 9 dhjetor 2024. Presidenti Thaçi nuk u arrestua sepse mbahet i arrestuar më shumë se katër vite në Burgun e Hagës. Prokuroria e Inkuizicionit Special kundër UÇK-së dhe shqiptarëve ngriti një aktakuzë duke cilësuar si një grup i organizuar dhe i angazhuar për të penguar administrimin e drejtësisë duke bërë presion ndaj dëshmitarëve. E keqja që po përsëritet është se Policia e Kosovës po merr pjesë, në cilësinë e punëtorit fizik edhe gjatë bastisjes si dhe arrestimit të shqiptarëve, kryesisht ushtarë të UÇK-së, familjarë apo përkrahës

të luftës”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij reagimi, ndonëse procesi ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit është duke vazhduar para një trupi gjyqësor të korruptuar profesionalisht, moralisht dhe, mbase, edhe materialisht, nuk iu bëhet vonë që Thaçin ta akuzojnë edhe për një veprë tjetër që në shtetet normale nuk ndodh shpesh. “Në fakt, në ish-Jugosllavinë ka pasur raste kur shqiptarët gjatë procesit të gjykimit ngarkoheshin edhe një aktakuzë të castit për t’i dënuar disa vite më tepër. Kjo histori represive dhe regresive po përsëritet në Hagë nga mashtruesit juridikë, armiqësisht të disponuar kundër luftës për liri dhe UÇK-së. KMDLNj, që nga fillimi e ka kundërshtuar këtë gjykatë sepse ndanë “drejtësi” sipas kriterit etnik sikur që cakton përgjegjësinë gjithashtu sipas parimit etnik. Mbi 90 % për qind të viktimave nuk i trajton vetëm se janë shqiptarë sikur që falë 90 % për qind të atyre që planifikuan, nuk e penguan apo e kryen krimin shkak se janë serbë. Kësi rasti nuk mund ta gjeni askund në botë ku janë formuar gjykata për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që nga Gjyqi i Nyrembergut e deri

te ky monstrum juridik, GJSR në Hagë”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, kjo gjykatë është themeluar në kushte të një terrorizimi nga faktori ndërkombëtar ndaj deputetëve të Kuvendit të Kosovës kurse, me shantazh dhe mashtrime, i është bartë tërë autoriteti vendimmarrës kësaj organizate të përbashkët “juridike” në Hagë duke e zhveshur Kosovën 100 për qind nga ushtrimi i sovranitetit juridik ndonëse, nga të dyja palët thuhet dhe pranohet se GJSR është themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe se e njëjta është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës që rrjedhimisht nënkupton se duhet të punojë sipas ligjeve të Kosovës dhe duhet ta respektojë Kushtetutën e Kosovës. “Kjo gjykatë përkundrazi brutalisht ka dhunuar ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës sikur që shtetin e Kosovës e ka shpërfillur me paturpësinë më të madhe. Me Serbinë, prokurorinë dhe gjykatat e këtij shteti ka bashkëpunuar ngushtë dhe miqësisht e sidomos me shërbimet informative dhe kundërinformative nga ka siguruar dëshmitarë të sajuar dhe materiale që përbëjnë afërsisht 70 për qind të

materialeve “dëshmuese” dhe dëshmitarëve serbë dhe atyre që flasin shqip”, thuhet në reagim. KMDLNj ka vlerësuar se Gjykata Speciale Raciste nuk ka asnjë shenjë identifikuese të shtetit të Kosovës sikur që as gjuha shqipe nuk është zyrtare. “GJSR bashkëpunon me pushtetin aktual vetëm në dëm të të akuzuarve, që edhe e ka pëlqimin e tyre. Ky devijim juridik nuk është aspak transparent, askujt nuk i jep llogari dhe nuk lejon monitorim të pavarur. Nuk krijon kushte për një proces gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga politika dhe grupet e interesit. Në çdo mënyrë përpiqet ta pamundësojë mbrojtjen efektive të të akuzuarve. Brutalisht e shkelë parimin e publicitetit sikur që e dhunon prezumumin e pafajësisë përmes kërcënimeve publike të Baba Vangës - Ekaterina Trandafilova, Jack Smith etj. Deri më tani nuk është marrë asnjë vendim në favor të të akuzuarve, janë refuzuar thuaja të gjitha kërkesat e tyre. Të gjitha vizitat, të privileguara dhe jo të privileguara janë përgjuar, janë lejuar të vizitohen edhe nga persona që kanë dhënë informata te kjo prokurori dhe gjykatë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se Kuvendi i Kosovës ka pasur qëndrim qyqar duke mos guxuar as të kërkojnë respektimin e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria për të burgosurit, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. “Këta mjermanë, jo që nuk kanë guxuar të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut por, paturpësisht kanë marrë edhe

mëditje për këto vizita. Edhe vizitat i kanë bërë selektive, në baza politike dhe partiake. Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi disa herë i janë drejtuar GJSR për shkak të anshmërisë së tyre, çdo herë janë refuzuar. Çka iu mbetet të ndërmarrin në mbrojtje të drejtave të tyre për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht dhe nga grupet e interesit në kohën kur pushteti aktual është rreshtuar prapa prokurorisë dhe gjykatës?! 1. Të kërkojnë monitorues ndërkombëtarë dhe vendorë që do të monitorojnë gjykimin. 2. Të refuzojnë t’i përgjigjen pyetjeve në rrethana ekzistuese. 3. Ta refuzojnë këtë gjykatë në këtë përbërje. 4. Të mos marrin pjesë në gjykim dhe, si masë e skajshme 5. Greva e urisë për sensibilizim të opinionit për mohim të një të drejte elementare të njeriut për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht dhe nga grupet e interesit”, është thënë në këtë reagim. KMDLNj ka theksuar se në Kosovë do të duhej të organizoheshin më seriozisht të burgosurit politikë dhe veteranët e luftës në mbrojtje të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria që janë në Hagë sikur që edhe institucionet që do të dalin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 duhet ta dëshmojnë pronësinë mbi këtë gjykatë nëse vërtet është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe punon sipas ligjeve të Kosovës. “Nëse jo, atëherë po ky Kuvend duhet ta zhbëjë këtë trup të huaj në sistemin e drejtësisë të Kosovës që në seancën e parë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Kuçi dhe Kilaj deklarohen të pafajshëm para Gjykatës Speciale



HAGË, 9 DHJETOR - Ish-zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Drejtësisë i Kosovës, Hajredin Kuçi, është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e tij të parë të bërë më herët gjatë ditës. "Jam plotësisht i pafajshëm. Sot është një prej momenteve të errëta për mua si njeri i drejtësisë, që e ka profesion dhe mision tërë jetën, dhe jam identifikuar me drejtësi", ka thënë Kuçi në fjalën e tij para gjykatës, duke shtuar se aktakuzën e konsideron "prekje të dinjitetit". "Drejtësinë si profesion dhe mision do ta vazhdoj edhe nga sot, edhe në një pozitë tjetër, por prapë në funksion të saj dhe të vlerave që jam identifikuar. Më vjen keq për shqetësimet që ua ka bërë kjo akuzë anëtarëve të familjes sime", ka thënë Kuçi. "Unë nuk kam bërë asnjë vepër penale.

Unë jam i pafajshëm dhe kam besim të plotë se do të lirohem nga akuzat. Në aktakuzë jam me presidentin Hashim Thaçi. Më lejoni të them se Hashimin e kam mik, njihemi që vite të gjata dhe kemi punuar gjatë. Kemi punuar dhe udhëhequr mbi parimin e drejtësisë, respektimit të saj dhe kemi besuar në drejtësi".

Kuçi përballat me dy akuzat për mosbindje ndaj gjykatës. Prokuroria ka thënë se me vonë gjatë ditës do të bëjë kërkesë që Kuçit t'i ndalohet komunikimi me personat që janë pjesë e aktakuzës dhe persona të tjerë që dyshohen se kanë lidhje me rastin.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, Marjorie Masselot, ka thënë se do të marrë vendim pas parashtrimit të kërkesës. Edhe ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, është deklaruar

plotësisht i pafajshëm në paraqitjen e parë para Gjykatës Speciale, ku po përballat me aktakuzën e ngritur ndaj tij për ndikim mbi dëshmitarët lidhur me një rast tjetër që ndiqet penalisht në këtë gjykatë.

Pala mbrojtëse ka thënë se nuk do të tentojë ta bindë gjykatësen pse ka gabuar që ka kërkuar arrestimin e Kilajt, por ka shtuar se Kilaj ka treguar se është kandidat i mirë për lirim me kusht.

Pjesë e aktakuzës janë edhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shëf i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, dhe Fadil Fazliu.

Thaçi dhe Smakaj nuk janë deklaruar një ditë më parë për akuzat që rëndojnë ndaj tyre, ndërsa Fazliu dhe Kuçi janë deklaruar të pafajshëm.

Të akuzuarit pranë Dhomave të Specializuara kanë afat që brenda 30 ditëve të deklarohen rreth akuzave.

Gjykata Speciale është institucion që funksionon sipas ligjeve të Kosovës, por selinë e ka në Hagë të Holandës.

Kilaj, Smakaj dhe Fazliu janë arrestuar më 5 dhjetor, dhe një ditë më vonë janë dërguar në qendrën e paraburgimit në Hagë.

Ndaj Kuçit është lëshuar fletëthirrje për t'u paraqitur para Dhomave të Specializuara të Kosovës me seli në Hagë.

Në aktakuzën e re, Thaçi ngarkohet me tri akuzat për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; katër akuzat për shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe katër akuzat

për mosbindje ndaj gjykatës. Fazliu, Smakaj dhe Kilaj akuzohen për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe për mosbindje ndaj gjykatës.

Në versionin e redaktuar të aktakuzës prej 15-faqesh, thuhet se Thaçi është takuar me katër të akuzuarit e tjerë në qendrën e paraburgimit në Hagë dhe aty pretendohet se ai u ka dhënë udhëzime se si të dëshmojnë dëshmitarët në rastin kundër tij.

Aktualisht në Hagë është duke u zhvilluar gjykimi ndaj Thaçit dhe ish-kryerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Osmani takon raportuesin për Kosovën, Riho Terras, diskutojnë për zhvillimet në Kosovë

Prishtinë, 9 dhjetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim deputetin e Parlamentit Evropian dhe raportuesin i sapoemëruar për Kosovën, Riho Terras, të cilin e ka ular për emërimin, duke shfaqur gatishmërinë për bashkëpunim të thelluar për avancimin e integritimit evropian të Kosovës.

Gjatë takimit presidentja Osmani rikonfirmoi përkushtimin e palëkundur të Kosovës për integrim në BE, duke potencuar progresin e dukshëm në përbushjen e kriterëve të anëtarësimit dhe përafrimit me standardet evropiane.

Presidentja nënvizoi përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian si synim kyç për të ardhmen e vendit. Presidentja Osmani theksoi edhe përkushtimin e Kosovës për të drejtat e njeriut, sundim të ligjit dhe demokraci, duke paraqitur arritjet evidente. Në dritë të sulmit të fundit



terrorist në vend, presidentja Osmani bëri thirrje për bashkëpunim dhe mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë

për hetim të sulmit, duke konfirmuar përkushtimin për hetim profesional të rastit nga ana e institucioneve të Kosovës.

Ajo theksoi se ky sulm ka targetuar infrastrukturën kritike në vend, duke synuar të shkaktojë dëme të mëdha të cilat

do të ndikonin drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë drejtim ajo foli për rëndësinë kyçe të bashkëpunimit me qëllim të luftimit të mëtejshëm të bandave kriminale serbe të cilat mbështeten, trajnohen e paguhen nga shteti serb, si dhe komunikimit e koordinimit me qëllim të parandalimit të sulmeve të ngjashme në të ardhmen.

Ndër të tjera, në takim presidentja Osmani theksoi se është e rëndësishme që bashkësia ndërkombëtare të mbajë qëndrim unik ndaj veprimeve destabilizuese të Serbisë, përfshirë aktin e agresionit të shtatorit 2023 dhe sulmin e fundit terrorist në infrastrukturën vitale të Kosovës. Në takim, presidentja theksoi se është koha që masat e padrejta të BE-së ndaj Kosovës të largohen përfundimisht ngaqë, sipas saj, përveçse të padrejta, këto masa po i dëmtojnë drejtpërdrejt qytetarët e Kosovës.

11 dhjetori, afati i fundit për certifikimin e subjekteve politike

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se deri më 11 dhjetor 2024, në orën 16:00, subjektet politike (partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) kanë afat të dorëzojnë aplikimin e tyre për certifikim dhe listën me emrat e kandidatëve për deputetë për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. "Të gjitha partive

politike të regjistruara aktualisht në Republikën e Kosovës dhe koalicionet të deklaruara, KQZ, përmes Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) iu ka krijuar dhe dërguar 'userët', përmes të cilëve mund të qasen në platformë dhe të ngarkojnë aplikimin për certifikim dhe listën e kandidatëve për deputetë. Gjithashtu, KQZ, përmes Zyrës, do të krijojë 'userët'



edhe për të gjitha subjektet politike (iniciativat dhe kandidatët e pavarur) që kërkojnë të aplikojnë për

certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje", ka njoftuar KQZ-ja.

Ndër të tjera, KQZ thotë se me qëllim që subjekteve politike (partive politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) t'u ndihmohet në përdorimin e platformës, nëse kanë nevojë, Zyra ka vënë në dispozicion dy tavolina ndihmëse dhe këtë numër kontakti 038 200 81 010, i qasshëm nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Përrurohet renovimi i tri klinikave në QKUK

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Renovimi i infrastrukturës së korridoreve dhe pritoreve në tri klinika, në Radiologji, Biokimi Mjekësore dhe Kirurgji, i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 393 mijë euro.

Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, përrurojnë të hënën renovimet në Klinikën e Radiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Kurti tha se Shërbimi Klinik i Mjekisë Nukleare është pajisur me aparaturë SPECT-CT që, sipas tij, është e vetmja në rajonin e Ballkanit. "Këtu ku ndodhemi kemi bërë adaptimin e korridoreve dhe pritoreve, gjithashtu edhe në Biokimi Mjekësore dhe Kirurgji. Vlera e

gjithmbarshme është 393 mijë euro dhe punimet janë kryer mbi 90 për qind në të tri klinikat. Pikërisht këtu ku ndodhemi tani në Radiologji është përmblyllur me sukses. Kemi pasur për qëllim rregullimin e pritoreve dhe korridoreve për pacientë. I kemi trajtuar të gjitha elementet e enterierit që e bëjnë edhe punën cilësore të mjekëve, specialistëve dhe infermierëve. Kemi trajtuar muret, plafonin dhe dyert. Gjithashtu janë bërë shtatë sportele të reja. Para se të vinim këtu ishim në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare ku jemi pajisur me një aparaturë që është e vetmja në rajonin e Ballkanit", tha Kurti.

Ai tha se aparati i ri quhet SPECT CT dhe ka vlerë 850

mijë euro, i cili është blerë nga buxheti i shtetit. "SPECT CT përdor izotopet radioaktive për të krijuar imazhe funksionale dhe për të treguar se si funksionojnë organet ashtu edhe indet në trupin e njeriut, paralelisht me CT që krijojnë imazhe strukturore në detaje për anatomi dhe trupit dhe kombinimi i këtyre dy teknikave ndihmon në diagnostikimin më të saktë. Janë kryer edhe trajnimet e nevojshme me stafin", ka thënë Kurti.

Ministri Arben Vitia ka thënë se janë duke bërë investime edhe në aparatura të reja dhe moderne, në mënyrë që pacientët të diagnostikohen dhe të trajtohen në Kosovë. "Ne po bëjmë një investim të strukturuar sistematik dhe të



analizuar mirë në çdo klinikë në sistemin tonë shëndetësor, jo vetëm në QKUK, por edhe në spitale regjionale. Po ashtu, ishim dhe pamë një aparaturë e

cila është e vetmja në rajon. Do të thotë, investimet tona synojnë ta rrisin kualitetin e diagnostikimit të pacientëve në Kosovë dhe të intervenohet këtu", tha Vitia.

Akuzat e Kurtit ndaj medieve, AGK-ja: Dënojmë fuqishëm gjuhën ofenduese dhe shumë të rrezikshme të kryeministrit

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka deklaruar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka shfrytëzuar mbledhjen e partisë së tij, Vetëvendosje, "që të shënojë një tjetër sulm të papranueshëm kundër medieve".

Në fjalimin e tij, mes të tjerash, Kurti ka thënë se "mediet, që për çdo sulm e agresion të Serbisë ndaj shtetit tonë, fajtorin çdoherë e gjetën te qeveria jonë, por asnjëherë të Serbia, nuk meritojnë vëmendjen tuaj".



"Kurrë nuk kanë qenë më shumë media kundër katërvjeçarit tonë. Unë

besoj se kjo është për dy arsye apo ndoshta shkaqe themelore. E para, sepse ne nuk i paguajmë. E dyta, sepse tash mediet nuk frikësohen më nga pushteti", ka thënë Kurti.

AGK-ja e dënon fuqishëm "këtë gjuhë ofenduese dhe shumë të rrezikshme të kryeministrit Kurti", që i rendit mediet e Kosovës përkrah Serbisë. "Një fjalor i tillë i papranueshëm që vjen nga kreu i qeverisë, direkt në rrezik sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias. Është

koha e fundit që kryeministri Kurti të ndalojë së përdoruri një gjuhë të tillë të nxitjes së urrejtjes ndaj medieve, që pastaj reflektohet dhe shumëfishohet nga shumë prej votuesve të tij", thuhet në reagimin e AGK-së.

Organi që përfaqëson mediet në Kosovë thotë se në respektim të lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes, gazetarët dhe mediet në Kosovë duhet të lejohen që ta ushtrojnë punën e tyre për ta mbajtur përgjegjëse qeverinë, pa u penguar dhe intimiduar nga pushteti.

Hovenieri, takim lamtumirës me Bislimin: ShBA-ja është e përkushtuar për Kosovën sovranë dhe shumetnike

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka zhvilluar takim lamtumirës me zëvendëskryeministrin

Besnik Bislimi. Hovenieri në platformën "X" ka thënë se ia ka përsëritur Bislimit përkushtimit amerikan për një Kosovë demokratike dhe shumetnike. "Në takimin tim

lamtumirës me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi sot përsërita përkushtimin tonë për një Kosovë sovranë, demokratike dhe shumetnike dhe

përforcova mbështetjen tonë për përparimin e Kosovës drejt integriteteve evropiane dhe euroatlantike", ka thënë Hovenieri.



SBASHK-u vazhdon konsultimet për veprimet sindikale pas protestës së 4 dhjetorit, kërkon dialog me ministren Nagavci

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka vazhduar konsultimet gjatë fundjavës me kryesinë dhe udhëheqësit sindikalë nga nivelet komunale dhe universitare për ta vlerësuar rrjedhën e protestës së 4 dhjetorit, në të cilën morën pjesë rreth 2 000 udhëheqës sindikalë nga çerdhjet deri në universitetet e vendit. Sipas një njoftimi për medie, ky takim u zhvillua për t'i diskutuar hapat e ardhshëm sindikalë si dhe për t'i përcaktuar veprimet që do të merren varësisht prej situatës aktuale dhe reagimeve të institucioneve shtetërore. "Për ta vlerësuar rrjedhën e protestës së 4 dhjetorit, në të cilën morën pjesë rreth 2 000 udhëheqës sindikalë, që nga çerdhjet e deri

në universitetet dhe për të vendosur për veprimet sindikale sipas situatës aktuale, SBASHK-u edhe gjatë vikendit ka mbajtur takime e konsultime me kryesinë dhe me udhëheqës sindikalë komunalë e të universiteteve", thuhet në njoftim. Më tutje në njoftim bëhet me dije se SBASHK-u i përgëzon pjesëmarrësit në protestë dhe i falënderon për qëndrimin dinjitoz dhe masiv, duke theksuar se ky ka qenë një demonstrim i fuqishëm i solidaritetit sindikal dhe i angazhimit për të drejtat e punonjësve të arsimit. "SBASHK përgëzon kryetarët dhe anëtarët e kryesive të sindikatave për pjesëmarrje masive në protestë dhe për qëndrimin e tyre të dinjitetshëm, por shkreh kritika të arsyeshme ndaj ministres Nagavci, e cila as pas këtij veprimi sindikal nuk reflektoi



dhe prandaj u mor vendim që t'i dërgohet edhe një shkresë me kërkesën për takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe që të caktojë përfaqësuesit e MASHTI-t në komisionin e

përbashkët për të nisur negociimin për Kontratën e re Kolektive të Arsimit", theksohet në njoftimin e SBASHK-ut. SBASHK-u ka theksuar se, në rast se situata përkeqësohet dhe nuk

ka reagim nga autoritetet shtetërore, qeveria, veçanërisht ministrja Nagavci, do të mbajnë përgjegjësinë për çdo pasojë që mund të vijë nga një grevë e mundshme dhe nga mospërbushja e kërkesave të punonjësve të arsimit. "Të gjithë pjesëmarrësit në këto takime konsultative, duke u bazuar edhe në vendimin e Këshillit Drejtues, janë deklaruar që të vazhdohet me përpjekjet që me dialog të arrihen zgjedhje të pranueshme për kërkesat e anëtarësisë duke angazhuar edhe ndërmjetësuesin ligjor dhe nëse as pas kësaj nuk ka reflektim nga MASHTI, atëherë të vazhdohet me veprime sindikale deri edhe të greva e përgjithshme në tërë sektorin e arsimit dhe për situatat që do të krijohen faktor i vetëm është Qeveria e në veçanti Ministrija Nagavci", thuhet në njoftimin e SBASHK-ut.

Analisti Arton Demhasaj i bashkohet AAK-së, i hyn garës për deputet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Analisti Arton Demhasaj i është bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Paraqitja e tij është bërë në një konferencë për medie të hënën nga kryetari i kësaj partie, Ramush Haradinaj. Demhasaj do të jetë pjesë e garës për deputet nga kjo parti. Haradinaj u shpreh se Demhasaj ka dhënë kontribut të madh si pjesë e shoqërisë civile. "Arton Demhasaj bashkohet me ne si kandidat për deputet. Ka punuar për 16 vjet si aktivist në shoqërinë civile. Ka qenë bursist i Ambasadës Amerikane në programin për transparencë. Ka qenë i angazhuar 10 vjet analist në televizionet nacionale", ka thënë Haradinaj. Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka theksuar se Demhasaj nga sot do të



rrugëtojë me Aleancën për Kosovën fituese. "Duke e njohur për së afërmi z. Arton Demhasaj dhe familjen e tij, ndihem i përbushur që do të rrugëtojmë së bashku drejt fitores! Të jam mirënjohës

kryetar Haradinaj. Suksese Arton!", ka shkruar Ramosaj në "Facebook". Ndërkaq Arton Demhasaj ka thënë se 16 vjet angazhim sistematik për kauzën publike në kuadër të shoqërisë civile,

përbëjnë një kapitull kapital në jetën e tij. "Përgjatë këtyre viteve jam angazhuar dhe kam ecur për krahu qytetarëve, duke adresuar shqetësimet e tyre si në sferën e drejtësisë, antikorrupsionit, mbrojtjes së

ambientit dhe ekspozimit të abuzimeve që kanë renduar e cenuar atë çfarë e kemi të përbashkët: Kosovën", është shprehur ai. Demhasaj ka theksuar se ky rrugëtim sfidues e njëkohësisht motivues ka lënë gjurmë të mëdha e të pashlyeshme në formimin e tij, duke ndihmuar t'i kuptojë dinamikën e jetës sonë shoqërore, të cilat i ka bartur edhe gjatë debateve nëpër studiot televizive kombëtare. "Megjithatë, përkundër se sfera e shoqërisë civile përbën një veprimtari fisnike, ndryshimi real që i duhet vendit ndodh në kuadrin e asaj çfarë e përbën veprimtarinë politike. Prandaj sot po nis një rrugëtim të ri, tashmë me një kauzë politike, pranë Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe nën liderhipin e kryetarit Ramush Haradinaj, duke qenë kandidat për deputet në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025", ka thënë Demhasaj.

Policia apelon për kujdes të shtuar në përdorimin e rrjeteve sociale nga të rinjtë

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Policia e Kosovës është e fokusuar në mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve andaj apelon për kujdes të shtuar në përdorimin e rrjeteve sociale, sidomos platformës "TikTok", e cila kohët e fundit ka shpërndarë sfida që paraqesin rreziqe për shëndetin dhe sigurinë e të rinjve. "Kjo sfidë është një nxitje për të realizuar veprime përmes lojërave që mund të shkaktojnë lëndime dhe dëmtime të

ndryshme. Policia e Kosovës, kërkon mbështetjen e prindërve dhe komunitetit për të ndërgjegjësuar fëmijët dhe adoleshentët për rreziqet që mund të sjellë angazhimi i pjesëmarrjes në këto sfida. "Prindërit duhet të jenë të vëmendshëm mbi përdorimin e rrjeteve të ndryshme sociale nga fëmijët e tyre dhe t'i ndihmojnë ata në identifikimin dhe ofrimin e ndihmës për shmangien e përfshirjes se tyre në lojërat e dëmshme dhe të

rrezikshme. Policia e Kosovës është e angazhuar në mbështetje të komunitetit dhe të rinjve për një përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të rrjeteve sociale, dhe i bën thirrje çdo prindi dhe mësuesi të jetë i vëmendshëm dhe të inkurajojë përdorimin e teknologjisë për qëllime pozitive dhe edukative. "Super heronjtë nuk janë të vërtetë kujdesuni për veten dhe shokët tuaj. Mos u bëni pjesë e lojës që rrezikon jetën", ka njoftuar policia.



Shpërthimi në kanal in Ibër-Lepenc, IKShPK-ja: Uji mund të përdoret për pije

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se që nga dita e parë e ngjarjes së fundit në kanal in Ibër-Lepenc së bashku me Qendrën Rajonale të Shëndetësisë Publike në Mitrovicë (QRShP) kanë forcuar monitorimin e ujit për pije në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica", në impiantet e

trajtimin në Shipol, Balincë, Drenas dhe Shkabaj. "IKShPK gjatë këtyre ditëve nga të gjitha impiantet e lartcekura ka marrë gjithsej 100 mostra të ujit për analiza fiziko-kimike, 100 për analiza bakteriologjike si dhe 13 mostra për analiza në metale të rënda (në ujin e pa trajtuar dhe ujin nga rrjeti shpërndarës). Rezultatet laboratorike nga dy laboratorët, IKShPK dhe QRShP-Mitrovicë,

për katër ditët e fundit (e premte, e shtunë, e diele dhe e hënë, 06-09 dhjetor-2024) rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin e pijes për të gjithë parametrat e kërkuar sipas UA 10/2021 'Cilësia e Ujit të destinuar për konsum nga njeriu'. Prandaj bazuar në këto rezultate: Uji që nga sot (09.12.2024) mund të përdoret për pije", ka njoftuar IKShPK-ja.



Kosova duhet të investojë 2.8 miliardë euro për t'i ruajtur komunat nga ndryshimet klimatike

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kosova duhet të investojë së paku 2.8 miliardë euro gjatë dekadës së ardhshme për t'i ruajtur komunat, ekonomitë nga ndikimet katastrofike të ndryshimeve klimatike. Kështu ka thënë Massimiliano Paolucci me rastin e prezantimit të raportit për klimën dhe zhvillimin (CCDR) për Kosovën, të paraqitur nga grupi i Bankës Botërore.

Paolucci ka theksuar se për të nxitur një tranzicion të gjelbër në Kosovë duhet ta transformojë ekonominë e vet nga një ekonomi që mbështetet shumë në thëngjill në një vend që bazohet krejtësisht në teknologjitë e gjelbra. "Nëse shihni përreth nuk është lajm që klima po ndryshon në mënyra të paparashikueshme dhe se ky rajon i Ballkanit Perëndimor është përballur me shumë probleme nga valët e të nxehtit, vërshimet, që janë dëshmi e qartë për nevojën për të marrë veprime shpejt. Është e qartë se investimi për të trajtuar këto



çështje është një prioritet i lartë. Ky vend duhet të investojë së paku 2.8 miliardë euro gjatë dekadës së ardhshme për t'i ruajtur komunat, ekonomitë nga ndikimet katastrofike të ndryshimeve klimatike. Klima dhe ndryshimet klimatike janë mundësi për t'u zhvilluar më

mirë dhe për të krijuar punë më të vlefshme për njerëzit. Për të nxitur një tranzicion të gjelbër në Kosovë, për ta avancuar konkurrueshmërinë ekonomike, Kosova duhet ta transformojë ekonominë e vet nga një ekonomi që mbështetet shumë në thëngjill në

intensitetin më të lartë të karbonit në Evropë në një vend që bazohet krejtësisht në teknologjitë e gjelbra", tha ai. Në anën tjetër, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, derisa tha se ky raport shërben edhe si përkujtesë për ndryshimet që do të

planifikohen në këtë drejtim, ka shtuar se Kosova aktualisht ka një intensitet të lartë të energjisë prej pothuajse katër herë më e madhe se mesatarja e BE-së. "Ky shërben edhe si përkujtesë për ndryshimet që do të planifikojmë. Kosova aktualisht ka një intensitet të lartë të energjisë prej pothuajse katër herë më e madhe se mesatarja e BE-së, dhe kjo do të thotë se pa pasur nevojë të investojmë shumë në kapacitetet e reja, çfarë ne duhet të bëjmë paralelisht është që ta minimizojmë përdorimin e energjisë dhe ngritjen e eficiencës së energjisë në tërë ekonominë, posaçërisht në sektorin e banimit, por edhe në fushat e tjera ku duhet të planifikojmë më shumë që të bëjmë diçka në të ardhmen", tha Rizvanolli.

Ajo shtoi se përderisa po investojnë në energjinë e ripërtërishme, tashmë është planifikuar ndërtimi i kapaciteteve për ruajtje të energjisë në përgjithësi.

"Volkswagen"-i shtrëngohet për greva të reja të punëtorëve



BERLIN, 9 DHJETOR - Punëtorët e fabrikës më të madhe në Evropë, "Volkswagen", pritet të nisnin greva të reja në nëntë fabrika në Gjermani për herë të dytë brenda një jave. Grevat po shihen si mënyrë për rritje të presionit ndaj menaxhmentit, në ditën kur do të zhvillohet një raund i ri negociatash për ulje pagash dhe mbyllje të disa fabrikave brenda vendit. IG Metall, sindikata që përfaqëson shumicën e punëtorëve të "Volkswagen"-it, është duke injoruar thirrjen e kompanisë që punëtorët të pranojnë një ulje page prej 10-përqindësh, në mënyrë që t'i

ndihmojnë kompanisë për të mbetur konkurruese në treg. Sindikata është duke kërkuar që të 10 fabrikat në Gjermani të vazhdojnë të jenë të hapura dhe që rreth 130 000 punëtorët e "Volkswagen"-it të vazhdojnë të pranojnë garanci të punësimit. Greva katërorëshe ka nisur në mëngjesin e së hënës. Greva prek nëntë prej 10 fabrikave të kompanisë që janë funksionale në Gjermani. "Volkswagen"-i ka raportuar humbje të vogla në prodhim, pas grevës së parë, ka thënë një zëdhënës i kompanisë ditë më parë.

Komuna e Prishtinës miraton buxhetin për vitin 2025

Prishtinë, 9 dhjetor - Me 25 vota për dhe një abstenim, të hënën

komuna e Prishtinës ka miratuar buxhetin për vitin 2025. Buxheti për

vitin 2025 për Prishtinën do të jetë 128 milionë euro. Ky miratim i buxhetit

është bërë pasi që i njëjti ka dështuar të miratohet tri herë radhazi.



SKENARËT E ARDHSHËM Çfarë ndodh pas rrëzimit të regjimit?



Ka një pafundësi të panjohurash për të ardhmen e Sirisë, një panoramë ku parashikimet janë vërtetuar të gabuara në harkun e pak orëve. Pasi regjimi shtypës u shemb, kryengritësit duhet të gjejnë një mënyrë për të menaxhuar një vend të gjunjëzuar. Për të shmangur kaosin, hakmarrjen, zemërimin kundër një pushteti përgjegjës për krime të rënda. Euforia e çlirimit pas dekadash represioni mund të lërë vend për çdo gjë. Sinjalet pajtuese të dërguara nga lideri i HTS-së, Abu Mohammed al-Jolani, dhe lëvizjet për një tranzicion paraqesin përpjekje të mira për të menaxhuar krizën dhe dëshmi të një axhende të studiuar. Nga ana tjetër, ka nga ata që kujtojnë përvoja katastrofike: Iraku pas pushtimit amerikan, Libia post-Gaddafi ose Somalia më e largët. Në fakt, në këto orë kryefjala e shumë qeverive është “stabiliteti”, ndërsa vetë al-Jolani duhet t’i kushtojë

vëmendje sigurisë së tij personale.

Shpatulla e Hts

Siria është një mozaik i etnive, grupeve dhe milicive. Alavitë, sunitë, shiitë, kurdë, druze, të krishterë. Dislokimi i rebelëve është i ndarë në mënyrë të barabartë: shtytja përfundimtare u dha nga HTS, më tej u pasua nga forcat proturke, por ka akoma më shumë, formacione që mund të imponojnë autoritetin e tyre. Fitorja i bashkon, ajo që vjen pas mund t’i ndajë. Dhe kjo mund të varet edhe nga frymëzimet e jashtme. Me një aktor që ka aspiruar gjithmonë të luajë një rol parësor, Turqinë. Hts ka origjinë kaediste dhe pasi u “prish” me grupin mëmë u përpoq të ofronte një imazh tjetër dhe ofroi garanci për heqjen dorë nga xhihadizmi transnacional, duke preferuar të këmbëngulte në karakterin “nacionalist” në nivel politik,

ndërkohë që zbatonte rregullat islamike në rajonin e vendndihjes të vet. Megjithatë, ekziston një frikë e përhapur për një shtet me konotacion islamik dhe skajet më radikale brenda lëvizjes shihen me frikë, veçanërisht militantët e huaj (kinezë, çeçenë, uzbekë). A do të lodhen nga luftërat apo do të kërkojnë armiq të rinj? Pastaj është shpirti i dytë radikal i mishëruar nga Shteti Islamik, një kundërshtar i rebelëve, gati për t’u futur në tufën e revolucionit. Kurdët përfaqësojnë armikun numër një të Ankarasë, e cila kërkon të përdorë “brigadat” e kryengritësve të mbështetur prej saj për të nisur një sulm dhe në fakt ka pasur përplasjet e para. Kushdo që komandon në Damask do të duhet të shmangë zgjerimin e frontit. Të dhënat nuk janë të mira. Çështja ka të bëjë edhe me Uashingtonin: presidenti i ri Trump ka deklaruar se SHBA duhet të qëndrojë “jashtë”

mosmarrëveshjes dhe do të shohim nëse, sapo të hyjë në Shtëpinë e Bardhë, ai do të tërheqë rreth 900 ushtarë amerikanë të pranishëm në pozicionet në Kurdistanin sirian dhe në pozicionin strategjik të al Tanf, në kufirin me Jordaninë.

Depot e armëve

Shtetet e Bashkuara, në këto orë, po ndjekin me kujdes një dosje serioze: ka të bëjë me depot e mundshme të armëve kimike që u furnizoheshin besnikëve të Assadit. Pentagoni është i shqetësuar se mund të përfundojnë në duar të gabuara. Alarmi u dha nga Tel Avivi i cili kreu disa sulmeve kundër qendrave siriane të përfshira në zhvillimin e pajisjeve. Irani është humbësi i madh. Territori sirian ishte themelor për Boshtin e Rezistencës, koalicionin e milicive të sponsorizuara nga Irani, dhe mbi të gjitha për të ushqyer Hezbollahun libanez, i cili tani

po humbet prapavijën e vërtetë logjistike. Ai do të duhet të rishikojë programet e veta dhe të marrë parasysh presionin e ri të SHBA-së. Ndoshta Pasdaranët do të përpiqet të pengojnë projektet e Sirisë së re. Rusia, e poshtëruar, ka parë e pafuqishme fundin e asaj që kishte krijuar, përjetoi përvojat e vuajtura nga amerikanët në Saigon dhe Kabul. Pakti me Damaskun e kishte lejuar të kthehej me forcë në Lindjen e Mesme duke hapur bazat dhe duke u bërë protagonist. Çfarë do të ndodhë me instalimet e saj ushtarake? A do të gjejë zgjidhje të tjera? Sipas Tass, rebelët kanë dhënë garanci për sigurinë e tyre. Izraeli nuk humbi kohë në dërgimin e ushtarëve në zonën e çmilitarizuar në Golan, ai ka zënë pozicione në anën siriane të Golanit, po krijon efektivisht një rrip sigurie. Kënaqësia për përmbysjen e kampit pro-Iranit po shoqërohet me shqetësime për kërcënime të mundshme.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ademi takohet me përzgjedhësin Foda dhe drejtorin teknik Markus Weidner

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka zhvilluar sot një takim pune me përzgjedhësin Franco Foda dhe drejtorin teknik Markus

Weidner për të diskutuar rreth krijimit të një programi të punës dhe filozofie të lojës për të gjitha ekipet përfaqësuese të Kosovës. "Në këtë takim janë shkëmbyer idetë për krijimin e

një strategjie të tillë dhe formën e implementimit të kësaj strategjie nga ekipet U-15 deri te Kombëtarja A", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në këtë formë FFK-ja synon që ta

ngrehë edhe më tej nivelin e punës qoftë me futbollistët e ekipit A, qoftë me ata të grupmoshave, nëpërmjet një sistemi të unisuar të punës dhe mënyrës së lojës.



Bach: Kosova është histori e rrallë suksesi

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Dhjetë vjet më parë Komiteti Olimpik i Kosovës u anëtarësua në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (IOC). Me këtë rast në Kosovë po qëndron për vizitë presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach. Bach në konferencë për medie ka thënë se Kosova është shembulli më i mirë se si brenda një kohe shumë të shkurtër mund të arrihen suksese të mëdha. Ai ka theksuar se medaljet olimpike që Kosova i ka fituar me sportin e xhudos janë dëshmia e angazhimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në zhvillimin e sportit në vend. "Këto dhjetë vjet kanë dëshmuar histori suksesi në shumë aspekte. Sigurisht kemi pesë medalje olimpike që janë fituar, pastaj në tri Lojëra Olimpikë. Kosova ka marrë pjesë në to dhe për këtë i gjithë populli i Kosovës mund të jetë shumë krenar së

bashku me Komitetin Kombëtar Olimpik sepse këto suksese nuk vijnë nga qielli, por falë punës së palodhshme", ka thënë Bach. "Unë ia kam shtrënguar dorën Majlinda Kelmendit në vitin 2015. Ka qenë një moment shumë i veçantë për mua dhe sigurisht që pres me padurim që ta shoh sonte, ta përqafoj dhe t'i ndajmë disa kujtime të mira nga triumfi i saj i madh dhe që do të jetë një moment shumë emocional për mua", ka shtuar Bach.

Nga ana tjetër, presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës, Spyros Capralos, duke uruar drejtuesit e KOK-ut për këtë përvjetor, theksoi se një sukses tjetër të madh Kosova e shënoi edhe vitin e kaluar kur fitoi të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare në vitin 2030. Sipas tij, ky do të jetë një tjetër moment që Kosova të avancojë edhe më tutje në sport, sidomos duke ndërtuar infrastrukturë të re sportive,



por edhe të promovojë disiplinën e reja të sporteve të ndryshme. "Për të arriturat tuaja dua t'ju përgëzojë për dhjetë vitet e të qenit në lëvizjen tonë dhe për të gjitha sukseset që i keni pasur jo vetëm në sport me pesë medalje olimpikë, por edhe për Komitetin Olimpik të Kosovës i cili ka marrë pjesë aktive në çdo ngjarje që e kemi organizuar... Do të jeni nikoqirë të Lojërave Mesdhetare të vitit 2030. Kjo

është e rëndësishme, një ligj i ri është miratuar. Ai do të ndihmojë në ndërtimin e infrastrukturës, organizimin e kësaj ngjarje", ka theksuar Capralos.

Ndërsa presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, theksoi se në këto dhjetë vjet, të gjitha sukseset e arritura janë bërë edhe duke iu falënderuar mbështetjes dhe bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare sportive. "Po mos të kishim sukses në këto dhjetë vjet që ne krenohemi sot me dhjetë medalje të arritura në Lojëra Olimpikë e shumë medalje në Lojëra Mesdhetare e shumë medalje në lojëra botërore e evropiane, nuk do të kishte qenë madhështor ky 10-vjetor, por ne e kemi bindur gjithë komunitetin e sportit se ne e duam sportin dhe mund të arrijmë gjithçka kur jemi të bashkuar", ka deklaruar Krasniqi.

Para konferencës për medie,

presidenti Bach ka takuar edhe kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Nga ky takim Bach ka thënë se ka dalë i ngazëllyer me planet që qeveria ka për ta mbështetur zhvillimin e infrastrukturës sportive në Kosovë. Pas këtij takimi, zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani, në "Facebook" ka shkruar: "Krerët më të lartë të lëvizjes olimpikë, presidenti i IOC, Thomas Bach dhe presidenti i EOC, Spyros Capralos, u pritën sot nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, me rastin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në këto struktura. Kosova, me 5 medalje olimpikë të fituara përgjatë kësaj dekade, ka treguar potencialin e saj për të kontribuar në komunitetin olimpik global, duke u përgjigjur në mënyrën më të mirë ndaj mbështetjes së plotë dhe të fuqishme të këtyre organizatave".

Lenzelle Smith, MVP i javës së 11-të në Superligë

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Javë e 11-të e ProCredit Superligës dhuroi disa ndeshje interesante. Basketbollisti me indeksin më të lartë në këtë xhiro ishte Lenzelle Smith (36). Basketbollisti i Proton Cable Prizrenit në sfidën ndaj Vëllaznimit kishte dyshifror të dyfishtë prej 25 pikëve, dhjetë kërcimeve, derisa shtoi edhe tetë asistime e dy topa të vjedhur. Golden Eagle Ylli shkëlqeu ndaj Pejës, ku u dalluan Jalen Nesbitt dhe Lis Shoshi. Nesbitt e mbylli ndeshjen me 20 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime, kurse Shoshi me 14 pikë, 11 kërcime



dhe një asistim. Bora shënoi fitore të rëndësishme ndaj Bashkimit, ku u dallua Alex Aveion Lomax me 23 pikë, katër kërcime dhe shtatë asistime. Derbin e xhiros e fitoi Trepça ndaj Sigal Prishtinës, ku më i miri ishte Mikaille Tmusiq me 19 pikë, shtatë kërcime dhe katër asistime.

TOP PESËSHJA

Lenzelle Smith (Proton Cable Prizreni) 25 pikë, 10 kërcime, 8 asistime, 36 indeksi
Jalen Nesbitt (Golden Eagle Ylli) 20 pikë, 9 kërcime, 3 asistime, 28 indeksi
Alex Aveion Lomax (Bora) 23 pikë, 4 kërcime, 7 asistime, 25 indeksi
Lis Shoshi (Golden Eagle Ylli) 14 pikë, 11 kërcime, 1 asistim, 23 indeksi
Mikaille Tmusiq (Trepça) 19 pikë, 7 kërcime, 4 asistime, 20 indeksi

Pesëshja e javës në Superligën e femrave

Prizren, 9 dhjetor - Bashkimi fitoi në derbin e javës, duke mundur Penzën, ku Aulona Muadri tregoi një paraqitje të mrekullueshme me 24 pikë, 16 kërcime, tri asistime, ndërsa Caterion Thompson kontribuoi me 21 pikë, pesë kërcime, dy asistime. Junior 06 shënoi fitore ndaj Peja 03, duke regjistruar tri fitore dhe gjashtë humbje. Në një ndeshje dramatike, që përfundoi me rezultatin 77-75, nuk ishte vetëm Abigail Ogle, e cila shkëlqeu, por edhe Tanyia Gordon, e cila kontribuoi me 28 pikë, 11 kërcime dhe katër asistime - një paraqitje fantastike që ndihmoi ekipin e Junior 06 të shënonte fitore.



Në një ndeshje tjetër të rëndësishme, Prishtina siguroi fitore duke mundur Trepçën. Këtu, paraqitja e Jayla Johnson ishte më e mira me 23 pikë e 10 kërcime, derisa Alaina Rice, ndihmoi skuadrën me 11 pikë, 13 kërcime e shtatë asistime.

PESËSHJA E JAVËS

Aulona Muadri (KBF Bashkimi) 24 pikë, 16 kërcime, 3 asistime
Caterion Thompson (KBF Bashkimi) 21 pikë, 5 kërcime, 2 asistime
Brailyn Jarell Joseph (KFB Peja 03) 38 pikë, 12 kërcime, 2 asistime
Abigail Ogle (KBF Junior 06) 22 pikë, 5 kërcime, 9 asistime
Jayla Johnson (KBF Prishtina) 23 pikë, 10 kërcime.

Kabashi: Shihemi në festën e katërt të kampionit


SUHAREKË, 9 DHJETOR - Presidenti i skuadrës së Ballkanit, Arsim Kabashi, i ka paralajmëruar kundërshtarët në këtë edicion të Superligës, duke insistuar se therandasit nuk janë dorëzuar dhe se do të

rikthehen edhe më të fortë. Numri një i klubit nga Suhareka e bëri një postim në rrjetet sociale, duke u shprehur i bindur se vetëm therandasit e kanë recetën e titullit të kampionit dhe se

ekipi "Portokalli" do ta fitojë titullin e katërt të kampionit radhazi.

Pas dominimit absolut në tre sezonet paraprake, Ballkani e pati një rënie në këtë edicion, ndërsa e sheh veten 10 pikë

prapa lideres, Drita. "Epoka e Ballkanit vetëm sa ka filluar. Recetën e kampionit nuk e dinë të gjithë, ne ishim dhe do të jemi! Shihemi në festën e katërt të kampionit! Urime Festat!", ka shkruar Kabashi.




FFK-ja dhe Komuna e Vitisë nënshkruajnë Memorandum Bashkëpunimi

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur kryetarin e komunës së Vitisë, Sokol Hamiti. Me këtë rast, në kuadër të bashkëpunimeve të FFK-së me komunat,

është bërë nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit edhe me komunën e Vitisë. Objekt i këtij bashkëpunimi do të jetë realizimi i përbashkët i investimeve dhe punimeve për ndërtimin e

stadiumit në fshatin Prodesh të komunës së Vitisë, së bashku me objektet e tjera përcjellëse. Detajet e investimeve të secilës palë janë të përcaktuara në memorandum. Ky

bashkëpunim është pjesë e projektit të FFK-së "Çdo 45 ditë nga një fushë futbollit" dhe synon përmirësimin e infrastrukturës sportive nëpër të gjitha viset e Kosovës dhe ndihmon në



përmirësimin e kushteve për futbollistët dhe komunitetin lokal.

Batatina pasi mori licencën UEFA Pro: I gatshëm për Kosovën dhe për Shqipërinë, e synoj një klub evropian

TIRANË, 9 DHJETOR - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, është pajisur me licencën UEFA Pro pasi e përfundoi me sukses kursin për këtë licencë në Shqipëri. Dhe, nga Tirana, aty ku e mori licencën dhe epitetin "Prof", trajneri i Llapit ka reaguar përmes një postimi emocionues, duke e përshkruar rrugëtimin e tij, sakrificat dhe punën që e ka bërë gjatë kësaj periudhe, për të arritur deri këtu ku është sot.

Gjithashtu, nuk e ka fshehur synimin për ta drejtuar një klub evropian, por edhe për ta marrë në dorë Kombëtaren e Kosovës apo atë të Shqipërisë. "Të dashur familjarë e miq, dua t'ju njoftoj se nga sot jam pajisur me licencën UEFA Pro. Së pari dua ta falënderoj familjen time për mbështetjen e pakushtëzuar që ma bëri të mundur realizimin e ëndrrës sime profesionale. Me përkushtim dhe punë të pandalshme, arrita të pajisem me licencën më të lartë për trajnerë, UEFA Pro. Ky është një moment historik për karrierën time, të cilin e ndava me njerëzit që më kanë mbështetur gjithmonë. Falënderoj vëllezërit e mi, duke filluar nga presidenti i klubit, kryesinë, sponsorët, adhuruesit e Llapit dhe fansat e



mi, që më kanë mbështetur pa u lodhur. Ju dua dhe ju premtoj se një ditë do të ndiheni krenarë me mua, teksa synoj të çoj futbollin shqiptar në nivelet më të larta. Një falënderim i veçantë shkon për Federatën e Futbollit të Kosovës, për besimin dhe mbështetjen që më dha për të ndjekur këtë rrugë, si dhe për Federatën e Futbollit të Shqipërisë, që nga kursi bazë e deri te niveli Pro, ku u shkollova dhe u përgatita në mënyrën më të mirë për t'u bërë trajner profesionist", ka thënë Batatina. "Nga sot, qëllimi im është t'i shërbej futbollit kombëtar shqiptar, kudo që ka hapësirë, dhe të punoj që një ditë të drejtoj një skuadër të mirë

evropiane. Në një të ardhme të afërt, ëndrra ime është t'i ndihmoj kombëtarët tona shqiptarë që të kualifikohen në eventet më të rëndësishme evropiane dhe botërore. Ky është misioni im si trajner! Falënderoj të gjithë ata që kanë punuar me mua në këto 12 vjet: ndihmësit e mi, stafin tim të ngushtë dhe të gjithë lojtarët që kanë kontribuar në këtë udhëtim të gjatë. Jam krenar për disa prej tyre që sot shkëlqejnë në arenën ndërkombëtare dhe përfaqësojnë me dinjitet kombëtarët tona shqiptarë. Faleminderit nga zemra të gjithëve që kanë qenë pjesë e kësaj rrugë. Ky sukses është edhe i juaji!", ka shtuar Batatina.

SHKURT

Rafael Nadal ka arkëtuar 135 milionë dollarë në karrierën e tij

Njëzet vjet suksese, trofe dhe fitime të mira financiare. Pas më shumë se dy dekadash, Rafael Nadal i dha fund karrierës profesionale, duke i dhënë lamtumirën botës së tenisit një muaj më parë në Kupën Davis me kombëtaren e Spanjës. 37-vjeçari nga Manacor ka varur raketën e tij në gozhdë pas një karriere të zbukuruar me 92 tituj ATP, duke përfshirë 22 Slam. Kjo e ka bërë atë një nga sportistët më të mëdhenj të të gjitha kohëve, jo vetëm në tenis. Gjithashtu, shuma totale e të ardhurave të fituara në karrierën e Rafael Nadalit të jetë e madhe. Kjo shumë është përafërsisht 135 milionë dollarë. Një e ardhur kjo që është më e madhe se ajo e Roger Federer, që ka arkëtuar rreth 130 milionë dollarë në karrierën e tij. Në rast se do të shtohen edhe të ardhurat nga sponsorizimet, reklamimet dhe investimet, mendohet se Rafael Nadal ka kaluar shifrën e 500 milionë dollarëve arkëtime. Ai ka hapur edhe një akademi tenisi në Majorka. Gjithsesi, në krye të listës së tenisistëve me më shumë të ardhura është Novak Djoković, që luan ende. Ai ka fituar deri më tani mbi 185 milionë dollarë.

Edhe Arsenali në garë për Wirtz, Leverkuseni kërkon 150 milionë euro

Ishte i magjishëm sezonin e kaluar, ishte i magjishëm në "Euro 2024" dhe po vijon të dhurojë spektakël në fushën e blertë. Ylli gjerman Florian Wirtz konsiderohet si një ndër lojtarët më me shumë potencial për të ardhmen, teksa pas një sezoni ku shënoi plot 20 gola e dhuroi po 20 asistime, në 54 ndeshje ka tërhequr të gjithë të mëdhenjtë pas vetes. Sipas raportimeve më të fundit të prestigjiozës gjermane "Bild", pas interesimit të Bayern Munichut, Manchester Cityt e Real Madridit, në garë për shërbimet e 21-vjeçarit kanë hyrë edhe "topçinjtë" e Arsenalit, me teknikun Mikel Arteta që e pëlqen shumë talentin gjerman, megjithatë problem mbetet çmimi. "Aspirinat" kërkojnë jo më pak se 150 milionë euro për kartonin e tij, shifër goxha e madhe edhe për një klub si Arsenal.

Katër klube në garë për De Jongun

Frenkie de Jong do të largohet nga Barcelona më së largu në verë, por ekziston mundësia që ai të lëvizë edhe në janar. Mesfushori holandez thuhet se ka vendosur të largohet nga Barcelona pasi nuk e ndien veten më të rëndësishëm dhe pjesë e formacionit bazë. Sipas "Mundo Deportivo", mesfushori holandez po kërkon një largim nga klubi. Klubet kryesore tashmë po tregojnë interes për nënshkrimin e De Jong. Manchester United, Chelsea, Bayern Munich dhe Paris Saint-Germain thuhet se të gjithë janë të prirë për t'i siguruar shërbimet e tij. E ardhmja e De Jong te Barcelona ka qenë e pasigurt për një kohë. Ai ka kontratë deri në vitin 2026, dhe klubi fillimisht kishte planifikuar ta zgjaste kontratën e tij. Megjithatë, situata tani ka ndryshuar. Barcelona raportohet se po konsideron shitjen e De Jongut, me një lëvizje që ka të ngjarë të ndodhë në verën e vitit 2025.

Clevelandi ndalet nga Miami, lakersat e Golden States rikthehen te fitorja

MIAMI, 9 DHJETOR - Skuadra kryesuese e Clevelandit u mund me rezultat 122-113 nga Miami, por ruan kreun e renditjes si në Konferencën e Lindjes ashtu edhe në NBA. Tyler Herro me 34 pikë ishte më i miri në fushë për Miamin. Një ndeshje magjike për Nikola Jokiqin, që realizoi 48 pikë e 14 rebounde për Denverin, në fitoren me rezultat 141-111 në fushën e Atlanta. Jashtë fushës fitoi edhe Milwaukee, që mundi me rezultat 118-113 Brooklyn (Antetokounmpo 34 pikë).



Rikthehet te fitorja ekipi i lakersave, që mundi me rezultat 107-98 Portlandin, sfidë ku Anthony Davis realizoi 30 pikë e 11 rebounde. Fitoi edhe Golden

State, 114-106 ndaj Minnesotas, takim ku Stephen Curry realizoi 30 pikë.

REZULTATET

Chicago - Philadelphia	100-108
Brooklyn - Milwaukee	113-118
Indiana - Charlotte	109-113
Atlanta - Denver	111-141
Miami - Cleveland	122-113
Orlando - Phoenix	115-110
San Antonio - New Orleans	121-116
Washington - Memphis	112-140
Golden State - Minnesota	114-106
Clippers - Houston	106-117
Sacramento - Utah Jazz	141-97
Lakers - Portland	107-98

Simeone: E vështirë kur konkurron me dy përbindësia si Barça e Reali

Atletico Madridi fitoi 4-3 ndaj Sevillas në një ndeshje të çmendur në La Liga, sukses që mban skuadrën e trajnerit Diego Simeone pranë Barcelonës e Real Madridit në renditje. Fitore që erdhi në minutat shtesë pas

një goli të Griezmannit. "Duhet të vazhdojmë të përmirësohemi. Skuadra funksionon shumë mirë, si një bllok kompakt. Skuadra beson në atë që bën. Griezmanni është një lojtar i veçantë, nuk ka pasur një pjesë

të parë të mirë, por në pjesën e dytë ai u rrit e na dha fitoren", ka thënë Simeone. Duke folur për lojën e ekipit të tij, trajneri argjentinas ka shtuar: "Atletico ka evoluar shumë në lojën e tij. Ne punojmë për të marrë më të

mirën që kemi. Kemi fituar dy tituj të La Ligës dhe disa trofe të tjerë, por skuadra ka qenë gjithmonë konkurruese, ka arritur të vendoset në vendin ku i takon. Kjo është arsyeja pse kërkesa është në rritje dhe ne

duhet të jemi të gatshëm ta mbështesim atë. Ne vazhdojmë të mendojmë lojë pas loje. Gjithsesi, titulli mbetet i vështirë kur duhet të konkurrosh me dy përbindësia si Barcelona e Real Madridi".

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Roto Recycling" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për riciklimin dhe prodhimin e plastikës në Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.02.2025 në ora 10:00 në hapësirat e SH.F.M.U "Dr. Ibrahim Rugova", fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit do të organizohet debat publik nga Kompania "Roto Recycling" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ; passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Roto Recycling" Sh.p.k. Prishtinë për fabrikën për riciklimin dhe prodhimin e plastikës në Obiliq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Njoftim për shuarjen vullnetare të "INSTITUT IGH" D.d. - Dega në Kosovë

Njoftojmë të gjithë klientët se "INSTITUT IGH" D.d. - Dega në Kosovë, me Numër Unik të Identifikimit: 810842717 me adresë të regjistruar: Rruga Ganimete Terbeshi, Nr. 26, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës, ka marrë vendim mbi shuarjen/likuidimin vullnetar të shoqërisë.

Njoftohen të gjithë Kreditorët eventual që të paraqiten pranë kësaj shoqërie lidhur me ndonjë kërkesë eventuale ndaj korporatës, në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes në gazete.

Obavestjenje o Volonterskoj Likvidaciji "INSTITUT IGH" D.D. - Filijala u Kosovu

Obavestavamo sve klijente da je "INSTITUT IGH" D.d. - Filijala u Kosovu, sa jedinstvenim identifikacionim brojem: 810842717, registrovana adresa: Ulica Ganimete Terbesi, br. 26, 10.000, Prishtina, Republika Kosovo, doneo odluku o volonterskoj likvidaciji/zatvaranju kompanije.

Obavestavamo sve potencijalne poverioce da podnesu soja potrazivanja prema kompaniji u roku od 30 dana od dana objavijivanja u novinama.

Notice on voluntary liquidation of "INSTITUT IGH" D.D. - BRANCH IN KOSOVO

We hereby inform all clients that "INSTITUT IGH" D.d. - Branch in Kosovo, with Unique Identification Number: 810842717, registered address: Str. Ganimete Terbeshi, No. 26, 10,000 Prishtina, Republic of Kosovo, has decided to proceed with the voluntary liquidation/ closure of the company.

We notify all potential creditors to submit any claims they may have against the corporation within 30 days from the date of publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sevdiye Salihu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qira , ne lagjen Dardania afër qershori deri me 1 Postës Kryesore (posta e Madhe) gusht (dy muaj), çmimi sipas Kroj i Bardhe, banesa është e marrëveshjes. Për informata në tel. mobiluar tërësisht. Për informata 044/171-328. lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra €uro. Banesa lëshohet për afate të katrorë dhe është e gatshme për gjata dhe të shkurtra. Informata në banim. Më shumë informata në: tel: 049\44-888-801 (viber) 044/706-079.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "GREENHOUSE" Sh.p.k. Radafc, Pejë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për punimin, monitorimin dhe ekspozimin e objekteve nga druri i parafabrikuar në Llabjan, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.02.2025 në ora 11:00 në hapësirat e SH.F.M.U "Haxhi Zeka" në Zahaq komuna e Pejës do të organizohet debat publik nga Kompania "GREENHOUSE" Sh.p.k. Radafc, Pejë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ; passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "GREENHOUSE" Sh.p.k. Radafc, Pejë për fabrikën për punimin, monitorimin dhe ekspozimin e objekteve nga druri i parafabrikuar në Llabjan, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

